STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 20 dhjetor 2012

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON RIHAPJEN E TUNELIT MONTAG (MONTAGUE), TRENAT R PRITET TE FILLOJNE SHERBIMIN NDERMJET BRUKLINIT (BROOKLYN) DHE MANHATANIT (MANHATTAN)

Lidhja kryesore ndërmjet distrikteve rivendoset për pikun e mëngjesit të së premtes

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se pas më shumë se një muaj pune pa pushim në një nga pjesët më të shkatërruara nga stuhia të sistemit të tranzitit të MTA-së, trenat R pritet të rifillojnë shërbimin përmes Tunelit Montag (Montague), që lidh Brooklyn Heights me Manhatanin e Poshtëm (Lower Manhattan).

Shërbimi në Linjën R ka funksionuar vetëm ndërmjet 34th Street dhe Whitehall Street që më 3 dhjetor. Megjithatë, me hapjen përsëri të Tunelit Montag (Montague), shërbimi i trenit R do të fillojë funksionimin ndërmjet Jay St – MetroTech dhe Whitehall St. në kohë për periudhën e pikut nesër në mëngjes.

"Përgjatë disa javëve të kaluara Linja e Lexington Avenue ka qënë e mbingarkuar. Banorët e Stejtën Ajlënd (Staten Islande) kanë qënë të detyruar që të gjenin rrugë alternative për në qendrën e qytetit dhe udhëtarët e metrosë nga Bay Ridge kanë duruar udhëtime dhe transferime të gjata," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Kthimi i rrugës R me gjatësi të plotë është një arritje e madhe që do të heqë një pjesë të presionit për 65,000 udhëtarët që e përdorin këtë linjë çdo ditë."

"Me rifillimin e shërbimit të trenit përmes Tunelit Montag (Montague) kemi ndërmarë një hap drejt rikthimit të sistemit të metrosë në nivelin e tij të plotë përpara stuhisë," tha Presidenti i Tranzitit të MTA-së të Qytetit të Nju Jorkut (New York City) Thomas F. Prendergast. "Kjo ishte një punë e gjatë dhe e vështirë që kërkoi zëvendësimin e elementëve përbërës dhe rindërtimin e sistemeve përpara sesa trenat të mund të funksiononin përsëri."

Lidhja nën lumë u prish si rezultat i dëmit të shkaktuar nga vërshimi masiv i ujit me kripë gërryes, që la të përmbytur shinat, sinjalet dhe elementët përbërës elektrike për disa ditë. Përmbytja u shtri për një hapësirë prej më shumë se 4,000 këmbë, duke kërkuar pompimin e 27 milionë gallonë ujë dhe heqjen e tonelatave të mbeturinave që kishin përfunduar në tunele. Dëm të konsiderueshëm kishin pësuar futje e korrentit dhe elementët e komandimit të një dhome të

pompimit dhe dy central të ventilatorëve humbën kur elementët përbërës dhe komandimi për këto pompa dhe ventilatorë u dëmtua rëndë.

Sistemi elektrik dhe ai i sinjaleve u desh të rindërtohej pothuajse nga fillimi, përfshirë lidhjet, reletë, qarqet e shinave, motorrët e dritave të ndalesave dhe pajisjet e tjera që kanë lidhje me lëvizjen e sigurtë të trenave të metrosë.

Ndërsa punë e mjaftueshme është kryer për të rifilluar përdorimin e sigurtë të shërbimit të trenit, pezullime të përkohëshme të shërbimit do të jenë të nevojshme në të ardhmen për të lejuar që punëtorët të hyjnë dhe të bëjnë riparime të përherëshme. Një pjesë e kësaj pune mund të bëhet nën FASTRACK, por shumica e përpjekjes do të kërkojë pezullime të kufizuara të shërbimit në javët dhe muajt e ardhshëm.

Dy zona të sistemit të metrosë mbeten jashtë shërbimit ---Linja A ndërmjet Hauërd Biç (Howard Beach) dhe Rokëuejs (Rockaways) dhe Linja Nr. 1 në jug të Stacionti Rector Street në Manhatanin e Poshtëm (Lower Manhattan). Puna vazhdon në të dy vendndodhjet.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418